BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# NJOFTIM MBI ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

*Në përputhje me nenin 47 të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)*

Data: 20.05.2025

**I.** "Banka Qendrore e Republikës së Kosovës"
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë

**II.** Lënda e procedurës së prokurimit:

**II.1** Titulli i kontratës: **"Furnizim me material shpenzues zyrtar"**
**II.2** Numërtimi i prokurimit: "BQK 25 020 134"
**II.3** Lloji i procedurës: *Procedurë për kuotim çmimesh*
**II.4** Lloji i prokurimit: Furnizim
**II.5** Numri i tenderëve të pranuar: 2 (dy)

**III.** Anulimi i procedurës së prokurimit:

**III.1** Data e anulimit të procedurës: 20.05.2025

**III.2** Arsyeja e anulimit: Anulimi i kësaj procedure të prokurimit është bërë në përputhje me "Rregullën për Prokurimin në BQK", konkretisht sipas nenit 47. . Vendimi i Bankës Qendrore për anulim është në pajtim me parimet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulle dhe sipas kushteve të dosjes së tenderit "BQK 25 020 134", me ç'rast pas vlerësimit të dy ofertave është konstatuar se ato asnjëra nuk janë të përgjegjshme.

**IV.** Ankesat

Në përputhje me "Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024), respektivisht sipas Neni 48 "Procedura e ankesës", çdo palë e interesuar[1] mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës

[1] "Palë e interesuar", sipas pikës 1.26 të nenit 2 të "Rregullës për Prokurimin në BQK" cilësohet operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.

përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.